



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 04/L-158

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-163 PËR
MINIERAT DHE MINERALET**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT NR. 03/L-163
PËR MINIERAT DHE MINERALET**

Neni 1

Neni 1 i ligjit bazik, fjalia „**për të mirën e**” zëvendësohet me togfjalëshin "**në funksion të zhvillimit ekonomik të**".

Neni 2

1. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Termet e perdorura ne këtë ligj kanë këtë kuptim.

2. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.1. **Zonë me interes të veçantë** – një zonë fizike/gjeografike e shpallur si e tillë nga organi kompetent.

3. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. fshihen nënparagrafet 1.4.; 1.7.; 1.11.; 1.12.; 1.17.; 1.23.; 1.24.; 1.26.; 1.32.; 1.45.; 1.46.; 1.47.; 1.58. dhe 1.59.; dhe paragrafet 4., 5. dhe 6.

4. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.8. fjala „**zhvleftësimi**“ zëvendësohet me „**amortizimi**“.

5. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.16. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.16. **Vlerësimi i ndikimit mjedisor** – dokumenti bazë i cili hartohet në pajtim me Ligjin për vlerësim të ndikimit në mjedis.

6. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.18. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.18. **Hulumtim** – aktivitetet që kanë për qëllim konstatimin e prezencës, cilësisë dhe sasisë së resursit mineral.

7. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.20. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.20. **Licencë për hulumtim** – të drejtën e fituar nga KPMM për kryerjen e punimeve kërkimore gjeologjike.

8. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.22 riformulohet me tekstin si në vijim:

1.22. **Program i Hulumtimit** – dokumentin bazë për aplikim për licencë hulumtimi, përmbajtja e të cilit përcaktohet sipas rregullores të nxjerrë nga institucioni përkatës.

1.22.1. **Mostrat fizike** – çdo moster e nxjerrur nga punimet hulumtuese gjeologo-minerale me qëllim të caktimit të vetive fiziko mekanike, kimike, petrografike.

9. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.27. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.27. **Strategjia Minerare** – dokumentin kornizë më të cilin përcaktohen politikat afatgjate të sektorit minerar.

10. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafët 1.29. 1.30. dhe 1.38. fjala “zonën” zëvendësohet me fjalën “sipërfaqe/hapsirë”.

11. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.33. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.33. Minierë – tërësinë e punimeve minerare mbi sipërfaqe apo nëntokësore të hapura më qëllim të nxjerrjes së mineralit. Në kuader të minieres përfshihen edhe objektet infrastrukturore dhe objektet tjera në shërbim të realizimit të aktivitetit minerare.

12. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.34 fjala “pjesëve” zëvendësohet me fjalën “procese”. Në fund të paragrafit fshihet teksti “duke përjashtuar këtu naftën dhe gazin natyror”.

12.1. Pas nënparagrafit 1.34, shtohet nënparagraf i ri 1.34.a. me tekstin si në vijim:

1.34.a. **Minerar/e** - aktivitetin minerar që ndërmerren me qëllim të hulumtimit, identifikimit, vlerësimit, shfrytëzimit, përpunimit si dhe deponimit të resurseve minerale.

13. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.40. fjala “gërmim” zëvendësohet me “nxjerrje”.

14. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.41. referenca 1.9 zëvendësohet me referencën 1.8.

15. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.42. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.42. **Ministër** - Ministri i Ministrisë përkatëse për sektorin minerar.

16. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.43. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.43. **Ministria** – Ministrinë përkatëse për sektorin minerar.

17. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.44. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.44. **Muzeu „TREPÇA”** – institucionin shtetëror për grumbullimin, ruajtjen dhe ekspozimin e mineraleve/kristaleve i themeluar me ligj.

18. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.53. fjala “**evropiane**“ zëvendësohet me “**ndërkombëtare**“.

19. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.54. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.54. **Licenca për mbajtjen e të drejtave minerare** – ruajtjen e të drejtës minerare të fituar nga KPMM për një periudhë të caktuar kohore.

20. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.56. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.56. **Marveshja për të drejten e qasjes në pronë** – një marveshje ndërmjet një aplikuesi, bartësi të licencës ose lejes dhe një pale të tretë që ka të drejta pronësore të regjistruara në mënyrë të ligjshme, që parashtruesi i kërkesës, bartësi i licencës ose lejes propozon ti shfrytëzojë ose është duke i shfrytëzuar për ushtrimin e aktiviteteve të autorizuara me këtë ligj - që e autorizon parashtruesin e kërkesës, bartësin e licencës ose lejes për ushtrimin e aktiviteteve në fjalë.

21. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.57. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.57. **Ndërmarrje** – ndërmarrja e përcaktuar sipas ligjit për shoqëritë tregtare.

22. Neni 3 i ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.59. shtohet përkufizimi i ri 1.60. me tekstin si në vijim:

1.60. **Garanci Bankare** - është premtimi me shkrim i bërë nga një bankë për të bërë pagesën për KPMM-në në rast të dështimit nga ana e bartësit të licencës

23. Neni 3 i ligjit bazik, paragrafi 2., “**Grupi 1 Mineralet Energjetike**”, pas fjalës “**hidrogjen**“ fshihet teksti “**mirëpo nuk nënkupton dhe nuk përfshin naftën dhe gazin natyror**”.

Neni 3

Neni 4 i ligji bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 4

Autorizimi i nevojshëm për hulumtim ose shfrytëzim

Asnjë person nuk mund të ushtrojë aktivitete të hulumtimit, shfrytëzimit dhe/ose përpunimit të resurseve minerale ose çfarëdo aktiviteti tjetër pa licencë ose leje të lëshuar nga KPMM në përputhje me këtë ligj.

Neni 4

Neni 7 i ligjit bazik, paragrafi 3., fshihet teksti **”Shuma e taksave në fjalë duhet të jetë në pajtim me praktikat më të mira ndërkombëtare.”**

Neni 5

Neni 8 i ligjit bazik paragrafi 3., riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Për dorëzimin e zones së licences së hulumtimit aplikuesi duhet të sjell në KPMM kordinatat e zones që do të mbahet dhe arsyeshmerin e dorëzimit të zones. Nëse aprovohet aplikacioni nga KPMM atëherë lëshohet aneks licence me sipërfaqe të reduktuar. Ndërsa për dorëzimin e zonës së licencës së shfrytëzimit aplikuesi duhet të sjell në KPMM kordinatat e zonës që do të mbahet edhe me tutje, arsyeshmerinë e dorëzimit të zonës dhe nëse zona e licences së shfrytëzimit është shfrytëzuar pjesërisht atëherë detyrohet i licencuari të bëjë rehabilitimin e zones së shfrytëzuar. Nëse aprovohet aplikacioni nga KPMM atëherë lëshohet aneks licence me sipërfaqe të reduktuar.

Neni 6

1. Neni 9 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2 fjala **„gjashtëdhjetë (60)”** zëvendësohet në **“tridhjetë (30) ditë“** dhe fjala **“njëqindnjëzet (120)”** zëvendësohet në **“gjashtëdhjetë (60) ditë“**. Dhe në fund të nënparagrafit 1.2. shtohet teksti si në vijim: **“Në rast të dështimeve të mëdha, i Licencuari do ta dorëzojë tek KPMM-ja planin e përmirësimit brenda tridhjetë (30) ditësh, përfshirë orarin e implementimit për shqyrtim dhe aprovim nga KPMM-ja“;**

2. Neni 9 i ligji bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.3, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. të përcaktojë masat të cilat bartësi i licencës/lejes kërkohet t'i marrë për të përmirësuar atë dështim, e cila mund të përfshin pagesën e gjobës administrative në pajtim me nenin 79 paragrafi 2. nga bartësi i licencës/lejes, nëse dështimi ka shkaktuar një gjendje seriozisht të rrezikshme;

3. Neni 9 i ligji bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.4., pas nënparagrafit 1.4.2 shtohet një nënparagraf i ri 1.4.3 me tekstin si në vijim:

1.4.3. paraprakisht nuk i është revokuar ose suspenduar ndonjë licencë ose leje apo i është inkasuar letra me vlrë nga KPMM, apo nga ndonjë agjencion rregullator për ambient apo minera ne Evropë, përveç kur veprimi i këtillë është zhvleftësuar ose anuluar nga një gjykatë kompetente;dhe

Neni 7

Neni 10 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 10

Transferimi dhe lënia peng e licencave dhe lejeve

1. Licenca ose leja nuk mund të lihet peng ose të ngarkohet më çfarëdo barre tjetër ligjore, qoftë me marrëveshje ose përmes detyrimit të ligjit.

2. Bartësi aktual i licencës i cili dëshiron që të bëjë transferimin e licencës së pari duhet që t'i përmbush të gjitha detyrimet e mbetura të licencës pavarësisht nëse këto detyrime lindin nga licenca, leja, ky ligj ose ndonjë element tjetër i ligjit të Kosovës- para datës së hyrjes në fuqi të transferimit.

3. KPMM në afat prej dy (2) muaj duhet t'i kthej aplikuesit për transferim të licencës një përgjigje lidhur me transferin e licencës apo jo. Nëse nuk transferohet licenca atëherë KPMM të jep një arsyetim lidhur me mos transferimin.

4. Licencat për hulumtim për mineralet per te cilat kohzgjatja është dy (2) vite, transferimi nuk iu lejohet pa kalimin e afatit prej një (1) viti.

5. Licencat per hulumtim per mineralet për të cilat kohzgjatja është tri (3) vite (mineralet metalike), transferimi nuk iu lejohet pa kalimin e afatit prej dy (2) viteve.

Neni 8

Neni 11 i ligjit bazik, paragrafi 1., fshihet fjalia “**të rendësishem**”.

Neni 9

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1. fshihet nga teksti i ligjit.
2. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. fjala “**njëqind (100)**” zëvendësohet me “**dyqind e pesëdhjetë (250) metra**”.
3. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.3. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. ndodhet në minimum brenda njëzet (20) metrave dhe më shumë (në varshmeni nga pjerrtësia e lejuar e shpatit të shfrytëzimit e planifikuar kjo ne projektin e shfrytëzimit) prej ndonjë toke që është pastruar ose lëvruar, ose në mënyrë tjetër të përgatitur për mbjelljen e farërave bujqësore ose mbi të cilën janë duke u rritur të mbjella bujqësore, përveç kur Bartësi i licencës ose lejes ka fituar të drejtat sipërfaqësore mbi këtë tokë;
4. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.6. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.6. është vend i ndonjë termocentrali, largpërçuesi tridhjet e pesë (35) KW dhe me lartë ose lumi ose është jo më larg se njëqind e pesëdhjetë (150) metra prej tyre; Termocentrali duhet të jetë njëqind e pesëdhjetë (150) metra ose jo më larg se njëzetë e pesë (25) metra nga larg përçuesit nëse aktiviteti minerar zhvillohet pa minim.
5. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.7. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.7. KPMM-ja të nxjerrët një UA lidhur me distancat në raport me kategorizimin e rrugëve dhe sistemin e shfrytëzimit të minierës.
6. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.8 fshihet nga teksti i ligjit.
7. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.9. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.9. është me afër se njëqind (100) metra larg varrezave;

8. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.10. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.10. është vendi i ndonjë monumenti antik ose monumenti kombëtar i caktuar me ligj dhe zyrtarisht dhe është me larg se njëqind (100) metra nëse nuk përdor eksplozive ose pesëqind (500) metra nëse përdoret eksplozivi.

9. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.11. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.11. është pjesë e një aeroporti privat apo publik ose zone sigurie të aviacionit në afërsi të aeroportit ne distancë prej pesëqind (500) metra.

10. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.13. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.13. në rast se përdoret eksplozivi dhe është me afër se pesëqind (500) metra nga ndërtesat ose objektet e banimit dhe objekteve tjera institucionale dhe publike.

Neni 10

Neni 14 i ligjit bazik, togfjalëshi **“me kujdes të arsyeshëm”** zëvendësohet me togfjalëshin **“në pajtim me kriteret e përcaktuara me ligj”**.

Neni 11

1. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 1 fjala **“të mbajë”** zëvendësohet me fjalën **“të ketë”**.

2. Neni 16 i ligjit bazik, pas paragrafit 1. shtohet paragrafi i ri 2. me tekstin si në vijim:

2. Secili bartës i licencës ose lejes duhet të mbajë në zyrën e përcaktuar më këtë nen, të gjitha shënimet dhe dokumentet e kërkuara me ligj. Mostrat fizike të cilat kërkojnë sipas këtij ligji po ashtu do të mbahen në këtë zyrë, përveç nëse një dispozitë e ligjit shprehimisht lejon që këto mostra të mbahen në një lokacion tjetër brenda Kosovës.

Neni 12

Neni 17 i ligjit bazik fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 13

1. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 2. nënparagrafi 2.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

2.1. është e dokumentuar se ajo zonë përmban vendburime të mineraleve të vlefshme metalore, industriale dhe/ose gurë të çmuar ose gjysmë të çmuar në atë sasi dhe me ato karakteristika që me arsye pritet se do të tërheqë interesin e ndërmarrjeve minerare me përvojë dhe me burime të shëndosha financiare; dhe

2. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Procesi konkurrues i paraparë në paragrafin 1. të këtij neni – përveç siç është përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni – do të ushtrohet nga Komiteti për Partneritete Publiko Private (KPPP) i themeluar sipas Ligjit për Partneritete Publiko Private.

3.1 të gjitha autoritetet publike, duke përfshirë KPMM-në, do t'i ofrojnë komisionit tenderues të gjithë ndihmën, këshillat dhe informatat të cilat komisioni tenderues mund të kërkojë për ushtrimin e rregullt të procesit të tenderimit.

3. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 6. afati kohorë **“brenda tridhjetë (30) ditëve”** zëvendësohet në **“brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve”**.

4. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 7. riformulohet me tekstin si në vijim

7. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, shprehimisht përcaktohet se kërkesa për proces konkurrues të tenderimit sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk do të aplikohet për një licencë për një Mineral Energjetik nëse, për shkaqe që ndërlidhen drejtpërdrejtë me nevojën për të siguruar sigurinë e furnizimit energjetik ose tërheqjen e investimeve të konsiderueshme direkte në Kosovë, Komiteti për PPP i rekomandon Qeverisë vendimin për aprovim me të cilin konstaton se ka interes publik në lëshimin e kësaj licence për një investitor specifik, Qeveria nxjerr një vendim të tillë të cilin e dërgon për miratim në Kuvend. Pas miratimit nga Kuvendi, KPMM duhet të lëshoj licencën atij investitori, me kusht që kushtet e licencës të jenë në përputhshmëri me dispozitat e aplikueshme të këtij ligji dhe investitori i përmbush të gjitha kriteret e kualifikimit të përcaktuara sipas këtij ligji.

5. Neni 18 i ligjit bazik, paragrafi 8. riformulohet me tekstin si në vijim

8. Pas nxjerrjes së një vendimi të tillë nga Kuvendi, Qeveria mund të hyjë në një marrëveshje për investim me investitorin specifik me kusht që:

8.1. ajo marrëveshje për investim është në përputhshmëri me ligjin e aplikueshëm,

8.2. marrëveshja për investim plotëson kushtet e licencimit të përcaktuara me ligj, dhe

8.3. marrëveshja për investim përfshinë përfitime si dhe shpërndarje optimale të rrezikut për Republikën e Kosovës duke tërhequr investime të konsiderueshme direkte apo sigurimin e sigurisë së furnizimit energjetik.

Neni 14

Neni 19 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.3. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. të ushtrohet në përputhje të plote me procedurat e përcaktuara sipas ligjit për Partneritet publik privat.

Neni 15

Neni 20 i ligjit bazik, titulli i nenetit riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 20

Regjistri i licencave për shfrytëzim, hulumtim apo leje për aktivitete të veçanta

Neni 16

1. Neni 21 i ligjit bazik paragrafi 1. nënparagrafi 1.2 riformulohet me tekstin si në vijim:

1.2. vlen për një zonë që nuk është më e madhe së pesëdhjetë (50) hektarë.

2. Neni 21 i ligjit bazik paragrafi 2. nënparagrafi 2.3. riformulohet me tekstin si në vijim:

2.3 mund të vazhdohet deri në dy (2) herë, ku secili vazhdim nuk mund të jetë më i gjatë se dy (2) vite; me kusht që, në rast të çdo vazhdimi të tillë, zona për të cilën Licenca e hulumtimit pastaj vlen, do të reduktohet për së paku pesëdhjetë përqind (50%).

3. Neni 21 i ligjit bazik, pas paragrafit 5. shtohet paragrafi i ri 6. me tekstin si në vijim:

6. Pavarësisht nga nënparagrafi 2.2 dhe paragrafit 5. të nenit 21 të ligjit bazik, një licencë për hulumtim e dhënë përmes nenit 18 të ligjit bazik mund të përfshijë një zonë me aq hapësirë sa është e mjaftueshme për ushtrimin e aktivitetit të hulumtimit.

Neni 17

Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 1. fjala “**dëshiron**“ zëvendësohet me fjalën “**shpreh interes**“.

Neni 18

1. Neni 23 i ligjit bazik, paragrafi 1., nënparagrafit 1.6. i shtohet teksti: “**Programi për hulumtim i propozuar nga aplikuesi bazohet në praktikat e mira të hulumtimit, shfrytëzimit, dhe mbrojtjes së mjedisit siç është aprovuar nga KPMM-ja në konsultim me MAPH dhe APK-në, ashtu si është e përshtatshme**”;

2. Neni 23 i ligjit bazik, paragrafit 2. pjesa e parë riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Brenda tre (3) muajve pas pranimit të aplikimit të plotë në kuptim administrativ dhe teknik nga aplikuesi i kualifikuar, KPMM lëshon licencën në fjalë apo i ofron aplikuesit si në vijim:

3. Neni 23 i ligjit bazik, pas paragrafit 4. shtohet paragrafi i ri 5. me tekstin si në vijim:

5. Personi që është i autorizuar me leje për kryerjen e një aktiviteti të veçantë nuk ka nevojë të paraqesë kërkesë për marrjen e një leje për ushtrimin e aktiviteteve të veçanta në fjalë.

Neni 19

1. Neni 24 i ligjit bazik, paragrafi 4. nënparagrafi 4.2. riformulohet me tekstin si në vijim:

4.2. do të ruajë dhe të mbajë nën kushte të mira në Kosovë, të gjitha mostrat fizike e marra nga ai në mënyrë qartazi identifikon datën dhe vendin e nxjerrjes së tyre. Në përfundim të licencës eksploruese, bërthamat apo mostrat e tjera gjeologjike do të

transferohen te një institut gjeologjik apo një agjenci në bazë të drejtimit nga KPMM-ja.

2. Neni 24 i ligjit bazik, paragrafi 4. nënparagrafi 4.4. riformulohet me tekstin si në vijim:

4.4. t'i dorëzojë KPMM-së, jo më vonë se me 31 tetor të çdo viti kalendarik, një program të hulumtimit për vitin vijues kalendarik

Neni 20

Neni 26 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. periudha kohore nga **“pesë (5) vite”** zëvendësohet në **“tri (3) vite”**.

Neni 21

Neni 28 i ligjit bazik, paragrafi 1., periudha kohore nga **“pesë (5) vite”** zëvendësohet në **“tri (3) vite”**.

Neni 22

Neni 30 i ligjit bazik, paragrafi 2., nënparagrafi 2.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

2.1 ka kohëzgjatje maksimale prej tridhjetë (30) viteve, përveç nëse cikli jetësor i investimit kërkon kushte të tjera më qëllim të sigurimit të sigurisë së furnizimit, të sigurimit të investimeve të konsiderueshme direkte, apo për të siguruar integrimin dhe harmonizimin me stabilimentet energjetike të prodhimit apo procesimit (“Stabilimentet Energjetike”) sipas kushteve për Stabilimentet e Energjisë të definuara në Ligjin për Energji.

Neni 23

1. Neni 31 i ligjit bazik, paragrafi 1., në nënparagrafin 1.8.2. në fund të nënparagrafit shtohet teksti: **“Ministria në bashkëpunim me KPMM do të nxjerrë akte nënligjore lidhur me përshkrimin në detaje të informatave të cilat duhet të përfshihen në planin e shfrytëzimit;”**

2. Neni 31 i ligjit bazik, paragrafi 1., nënparagrafi 1.9. në fund të nënparagrafit shtohet teksti: **“të përcaktuara në aktet nënligjore të aprovuara nga Ministria në bazë të ligjit”**.

3. Neni 31 i ligjit bazik, paragrafi 1., nënparagrafi 1.11. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.11. garancinë e performancës në formatin e nënshkruar nga KPMM që garanton disponueshmërinë e fondeve të mjaftueshme për të kryer, sipas nevojës, planin e mbylljes së minierës dhe programin e rehabilitimit, e cila do të jetë në shumën që është ekuivalente apo më e madhe se kostoja e vlerësuar e këtij plani apo programi, duke përfshirë emergjencat dhe do të jetë në fuqi për periudhën e plotë të performancës.

4. Neni 31 i ligjit bazik paragrafi 1. nënparagrafi 1.11. të shtohet teksti **“si dhe parashikimeve të KPMM-së sa i përket kostos inxhinierike për të rehabilituar lokacionin në pajtim me planin e miratuar për mbylljen e minierës dhe rehabilitimin e saj. Ky parashikim duhet bërë në bashkëpunim me MMPH-në, Agjencinë Pyjore të Kosovës, dhe Ministrinë”**.

5. Neni 31 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafit 1.11. i shtohen nënparagrafët si në vijim:

1.11.1. shuma e garancisë që duhet të paguhet bazohet në vlerësimet inxhinierike të KPMM-së për të rehabilituar lokacionin e minierës sipas planit të aprovuar për mbylljen dhe rehabilitimin e minierës. Kjo përlllogaritje do të bëhet në bashkëpunim me APK-në, MAPH-në dhe Ministrinë.

1.11.2. Garancia bëhet në formë të Garancioneve Bankare apo në formë të letrës me vlerë të investimeve të korporatës ose Qeveritare (AAA), apo Euro-Obligacione Sovrane dorëzohen në KPMM për t’u mbajtur në një bankë të aprovuar të licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës.

1.11.3. Rishikimi dhe rikalkulimi, sipas nevojës, i kostove të lidhura me mbylljen e aprovuar të minierës dhe detyrimin e rehabilitimit do të kryhet sipas nevojës por së paku një herë çdo tri (3) vite kalendarike nga KPMM në pajtim me kërkesat e nenit 31.11 të ligjit bazik.

1.11.4. Deri në deponimin e plotë të garancisë sipas nënparagrafit 1.11.2, të këtij neni bartësi i licencës deponon një pjesë të garancisë në shumën e përcaktuar nga KPMM në baza tremujore.

1.11.5. Mjetet e paguara si garancion për rehabilitim i kthehen kompanisë ças përfundimit të rehabilitimit në përputhje me projektet e aprovuara nga KPMM, MMPH dhe APK.

1.11.6. Pas dorëzimit nga ana e kompanisë të kërkesës për rimbursim, komisioni i përbërë nga KPMM, MAPH dhe APK do të vlerësojë situatën në teren dhe do të

dorëzohet raportin tek Bordi i KPMM-së. Nëse raporti është pozitiv atëherë KPMM-ja ia kthen letrën me vlerë të performancës apo fondet në bankë të Licencuarit.

1.11.7. Nëse raporti është negativ dhe/ose kompania nuk e ka përfunduar rehabilitimin e minierës në pajtim me planin për mbyllje dhe rehabilitim të mihjes, atëherë do të inkasohet letra me vlerë dhe/ose fondet do të kërkohen nga banka e aprovuar që t'i jipen KPMM-së për të proceduar me rehabilitim. Toka e rehabilituar do të bëhet pronë e Republikës së Kosovës përveç kur pronësia është siguruar nga pronarët privat gjatë periudhës së licencës së mihjes. Bordi i KPMM -së është i obliguar të merr një vendim brenda 30 ditëve për të inkasuar fondet e depozituara për rehabilitim.

Neni 24

1. Neni 32 i ligjit bazik, në paragrafët 2. dhe 3. afati kohorë prej **“tre (3) muaj“** zëvendësohet në **“gjashtëdhjetë (60) ditë“**.

2. Neni 32 i ligjit bazik, paragrafi 2. nënparagrafi 2.2. në fund të nënparagrafit shtohet fjalia **“Një listë me shkrim e mangësive të aplikacionit që përfshin edhe/ose ndryshimet e kërkuara së bashku me një shpjegim të KPMM-së mbi arsyet për marrjen e këtij vendimi, dhe”**.

3. Neni 32 i ligjit bazik, paragrafi 2. nënparagrafi 2.3. në fund të nënparagrafit shtohet fjalia **“Informatë me shkrim lidhur me të drejtat ligjore të parashtruesit të kërkesës, përfshirë riparashtrimin, ankesën dhe shqyrtimin gjyqësor të vendimit në fjalë.”**

4. Neni 32 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet paragraf i ri 4. me tekstin si në vijim:

4. Kurdo para skadimit të periudhës prej (1) muaji, të cilës i referohet në paragrafin 1. të këtij neni, KPMM, në rrethana të jashtëzakonshme dhe duke ushtruar të drejtë të arsyeshme, mund ta zgjatë periudhën për dy (2) muaj shtesë. Në rast të tillë, KPMM do të njoftojë menjëherë parashtruesin e kërkesës me shkrim për zgjatjen në fjalë dhe për arsyet e saj.

Neni 25

1. Neni 33 i ligjit bazik, paragrafi 1.3. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.3. programi i propozuar i shfrytëzimit, i aprovuar nga KPMM-ja është i bazuar në praktikat më të mira të shfrytëzimit dhe mbrojtjes së mjedisit, dhe siguron përdorimin efikas dhe fitimprurës të burimeve Minerale të zonës për të cilën kërkohet licenca;

2. Neni 33 i ligjit bazik, pas paragrafit 2. shtohet paragrafi i ri 3.me tekstin si në vijim:

3. Nëse Qeveria duhet të shpronësojë të drejtat sipërfaqësore siç përshkruhet në paragrafin 2 të nenit 33 të ligjit bazik apo, nëse KPMM përcakton, pas konsultimeve me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, se interesi publik do të shërbëhet më së miri në këtë mënyrë, KPMM mund të kërkojë nga bartësi i licencës që të paguajë tantiemat në avans.

3.1. këto tantiema të paguara në avans duhet të jenë më të vogla se tridhjetë përqind (30%) e tantiemës së prodhimit e cila do të paguhej në vitin e parë të eksploatimit apo kostoja aktuale e shpronësimit. Shuma e tantiemave të prodhimit të paguara për cilindo vit duhet të zbriten (por jo nën zero) nga shuma e tantiemave të paguara në avans sipas marrëveshjes, me kusht që ajo tantiemë e paguar në avans nuk është shfrytëzuar për të ulur tantiemën e prodhimit për një vit paraprak. Asnjë tantiemë avansi e paguar gjatë kohëzgjatjes fillestare të marrëveshjes nuk mund të shfrytëzohet për të ulur tantiemën e prodhimit për periudha shtesë të marrëveshjes.

3.2. në rast se bartësi i licencës pezullon prodhimin sipas nenit 35 të ligjit bazik, mund të kërkohet nga bartësi i licencës që të paguhet tantiemat në avans ose deri në vazhdimin e prodhimit ose ndërprehet licenca, përveç nëse operacionet sipas marrëveshjes janë ndërprerë për shkak të grevave, elementeve apo pasojave që nuk mund t'i atribuohen bartësit të licencës.

Neni 26

1. Neni 34 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Licenca për shfrytëzim i bart të licencuarit të drejtën ekskluzive në pajtim me kushtet dhe dispozita e licencës së shfrytëzimit .dispozita e këtij ligji përfshijne edhe aktet nernligjore te nxjerras ne bazë të këtij ligji dhe çfarëdo marrëveshje relevante për të drejta sipërfaqësore apo të drejtave sipërfaqësore që i ipen të licencuarit sipas paragrafit 2. të nenit 33 të ligjit bazik për të kryer operacionet minerare të specifikuar dhe veprimet e ndërlidhura hulumtuese, përfshirë mes tjerash , për:

2. Neni 34 i ligjit bazik, paragrafi 4. nënparagrafi 4.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

4.1. brenda tridhjetë (30) ditëve nga përfundimi i çdo tre mujori.

3. Neni 34 i ligjit bazik, paragrafi 4. nënparagrafi 4.2. riformulohet me tekstin si në vijim::

4.2. brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga përfundimit i çdo viti kalendarik;.

4. Neni 34 i ligjit bazik, paragrafi 4. nënparagrafi 4.3. riformulohet me tekstin si në vijim:

4.3. jo më vonë se me 31 tetor të çdo viti kalendarik, një program të aktualizuar të shfrytëzimit për vitin vijues kalendarik;

Neni 27

1. Neni 35 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. I Licencuari për shfrytëzim do të njoftoi me shkrim KPMM-në tre (3) muaj më parë në rast se mëton të pezullojë apo zvogëlojë prodhimin. Ky njoftim do të përfshijë një justifikim të detajuar për pezullimin apo zvogëlimin në fjalë dhe të përfshijë një parashikim mbi kohëzgjatjen e ndërprerjes së përkohshme.

2. Neni 35 i ligjit bazik, paragrafi 2., pas fjalisë së fundit shtohet fjala **“forca madhore”**.

3. Neni 35 i ligjit bazik, pas paragrafit 2. shtohet paragrafi i ri 3. me tekstin si në vijim:

3. Bartësi i licencës për mihje vazhdon t’i kryejë të gjitha aktivitetet e arsyeshme për të qenë në pajtueshmëri me lejet mjedisore dhe kërkesat shëndetësore dhe të sigurisë sipas ligjit gjatë periudhës së ndërprerjes së përkohshme.

Neni 28

Neni 39 i ligjit bazik, paragrafi 1., afati kohorë **„tre (3) muajve“** zëvendësohet në **„dy (2) muaj“**.

Neni 29

Neni 44 i ligjit bazik, paragrafi 2., nënparagrafi 2.2, riformulohet me tekstin si në vijim:

2.2. të përfshijë ose ndikojë në tokën ose pronën që administrohet drejtpërdrejt dhe në mënyrë të ligjshme nga Komuna, ose të jetë pronë private, por në kufi të komunës që kërkohet licenca.

Neni 30

Neni 45 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.2. një listë e shkruar e mangësive të aplikacionit dhe/ose amendamenteve të kërkuara për të sqaruar arsyet e KPMM-së për vendimet e tilla, dhe

Neni 31

Neni 51 i ligjit bazik, paragrafit 2 i shtohen nënparagrafët 2.1.,2.2.,2.3., 2.4.,2.5., dhe 2.6. me tekstin si në vijim:

2.1. me kërkesë të bartësit të licencës KPMM, mund të hyjë në marrëveshje me këste me pagesit e rentës minerare, përmes së cilave mund të paguhet renta minerare e mbetur, në përputhje me paragrafin 2. të nenit 52 të ligjit bazik, me afatet dhe kushtet e marrëveshjes.

2.2. kur pagesa e rentës kërkohet, paguesi dëshiron një marrëveshje për një periudhë më të gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj, interesi do të vazhdojë të rrjedhë gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes.

2.3. Paguesi i rentës minerare duhet të bie dakord të mbetet i rregullt në të gjitha detyrimet e tjera dhe ti kryej ato krahas marrëveshjes së nënshkruar, përfshirë kryerjen me kohë dhe saktësi të pagesave të tremujoreve dhe pagesave tjera nëse janë të aplikueshme sipas kushteve të licencës dhe ligjit në fuqi.

2.4. Nëse paguesi i rentës nuk i përmbahet një marrëveshje me këste, interesi do të rivendoset në mënyrë retroaktive deri në datën kur është nënshkruar marrëveshja. Nëse një pagues i rentës nuk mundet të përmbush obligimet sipas një marrëveshje me këste dhe dëshiron të ri-vendosë një marrëveshje me këste, marrëveshja me këste pasuese nuk do të përfshijë heqjen e interesit. Interesi do të vazhdojë të rrjedhë në çdo marrëveshje me këste pasuese për kohëzgjatjen e marrëveshjes.

2.5. Nëse bartësi i licencës nuk e paguan rentën minerare sipas afateve të kërkuara me ligj dhe akte tjera nënligjore KPMM përveç njoftimit për dështim në përputhje me nenin 9 të ligjit bazik, do të aplikoj edhe interesin për mos pagese në kohë.

2.6. Shkalla e interesit do të bazohet në shkallën e interesit të huadhënies së bankave tregtare në Kosovë, por duhet të jetë një minimum prej 0.5% në muaj më e lartë se ajo shkallë. KPMM përmes akteve tjera nënligjore do të përcaktojë një herë në vit, jo më larg se data 1 dhjetor, ndryshimet në shkallën e interesit për vitin pasardhës.

Neni 32

Neni 54 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.1. një vlerë që është kalkuluar në mënyrë të arsyeshme për ta kompensuar KPMM-në për shpenzimet administrative të procedimit të kërkesës apo përmbushjen e kërkesave dhe inspektimin dhe zbatimin e licencës gjatë kohëzgjatjes së saj, dhe

Neni 33

1. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - KPMM është agjenci e pavarur e përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

2. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 4. fshihet nga teksti i ligjit.

3. Neni 55 i ligjit bazik, paragrafi 5. riformulohet me tekstin si në vijim:

5. Paraqet vepër penale dhe shkelje të ligjit nëse një person ushtron ose tenton të ushtrojë ndikim politik, administrativ, financiar ose ndikim tjetër në KPMM-në, personelin ose menaxhmentin e saj.

Neni 34

Neni 56 i ligjit bazik, paragrafi 1. nënparagrafi 1.2. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.2. Pajtueshmëria e operimeve minerare me ligjin, aktet nënligjore të nxjerra në pajtim me ligjin dhe kushtet dhe afatet e licencave dhe lejeve të lëshuara nga KPMM, apo pëlqimeve të lëshuara si parakusht për miratim nga KPMM, në pajtim me ligj.

Neni 35

Neni 57 i ligjit bazik fshihet nga teksti i ligjit.

Neni 36

1. Neni 59 i ligjit bazik, paragrafi 5. pas fjalës **“Sekretar“** fjala **“i Përhershëm”** zëvendësohet me fjalën **“i Përgjithshëm”**.

2. Neni 59 i ligjit bazik, paragrafi 6. nënparagrafët 6.2. dhe 6.3. fshihen nga teksti i ligjit.

3. Neni 59 i ligjit bazik, paragrafi 7. fshihet fjala **“të vlefshme“** dhe fjala **“cilësore“**.

4. Neni 59 i ligjit bazik, paragrafi 8. teksti **“Mandatet e të gjithë pasardhësve të anëtarëve fillestar janë katër (4) vjet.“** zëvendësohet me tekstin **“Mandatet e të gjithë pasardhësve të anëtarëve fillestar janë pesë (5) vjet.“**

5. Neni 59 i ligjit bazik, paragrafi 10. afati kohor nga **“gjashtë (6) muaj”** zëvendësohet me **“tre (3) muaj”**.

Neni 37

Neni 60 i ligjit bazik, paragrafi 1. pas nënparagrafit 1.3. shtohet nënparagrafi i ri 1.4. me tekstin si në vijim:

1.4 nuk e ka ushtruar mandatin e tij në përputhje me këtë ligj, ligjet dhe aktet tjera nënligjore në fuqi.

Neni 38

Neni 61 i ligjit bazik, paragrafi 1., nënparagrafi 1.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.1. pranojë ose marrë parasysht çfarëdo punësimi, ose oferte nga cilido person i cili ka marrëdhënie afariste ose marrëdhënie tjetër me KPMM ose ka pasur marrëdhënie të këtilla me KPMM, më përjashtim të ndërmarrjeve publike dhe shoqërore

Neni 39

1. Neni 63 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Bordi i KPMM-së zgjedh Drejtorin në përputhje me Ligjin në fuqi për shërbimin civil.

2. Neni 63 i ligjit bazik, paragrafi 2. fjala **“emërohet”** zëvendësohet me fjalën **“zgjedhet”**.

3. Neni 63 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Drejtori i KPMM-së drejton veprimtarinë e zakonshme të KPMM-së. Dhe është për organizimin, emërimin dhe shkarkimin e personelit të KPMM-së në pajtim me legjisllacionin në fuqi.

4. Neni 63 i ligjit bazik, paragrafi 6. riformulohet me tekstin si në vijim:

6. Bordi e shkarkon Drejtorin nëse konstatohet se ai/ajo:

5. Neni 63 i ligjit bazik, paragrafi 7., fjala **“duhet të jetë”** zëvendësohet me fjalën **“behët”**.

Neni 40

Neni 65 i ligjit bazik, paragrafi 2. në fund të paragrafit shtohet teksti **“janë të hyra të përgjithshme për zhvillim ekonomik”**.

Neni 41

Pas nenit 66 të ligjit bazik shtohet pjesa X.A, me nenet 66.A dhe 66.B me tekstin si në vijim.

PJESA X.A PAGESAT

Neni 66.A Llojet e pagesave

1. KPMM do të grumbullojë pagesat për:

1.1. modifikimin dhe ndryshimin e licencave dhe kërkesave për licencë;

1.2. pagesa fillestare dhe vjetore për licencim;

1.3. pagesa tjera që mund të nevojiten për veprimtari monitoruese, inspektuese dhe zbatuese, me kusht që asnjë pagesë të mos tejkalojë koston reale që KMPP e ka pasur për rishikim, procedim, dhe/ose administrim të veprimtarisë për të cilën bëhet pagesa.

2. Për qëllime të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, të gjitha pagesat e specifikuar në paragrafin 1. të këtij neni do të jenë ‘pagesa të dedikuara’ të KPMM-së.

3. KPMM do të përgatisë dhe publikojë detajet e të gjitha pagesave të zbatueshme për momentin.

Neni 66.B Kryerja e pagesave

1. Pagesat për shqyrtimin e kërkesave do të paguhen në momentin e parashtrimit të kërkesës.

2. Pagesat për licenca/leje do të përbëhen nga:

2.1. pagesat fillestare për lëshim apo amandamentim të licencës/lejes, shpenzimet për përgatitje të licencës/lejes dhe realizim të rregullimit të veprimtarisë deri në fund të vitit aktual kalendarik; dhe

2.2. pagesat vjetore për realizimin e veprimtarisë së licencuar deri në fund të çdo viti pasues.

3. Pagesat vjetore do të paguhen nga i licencuari në fillim të çdo viti kalendarik apo përmes ratave mujore për të cilat është arritur marrëveshje me KPMM-në.

4. Me përjashtim të pagesave vjetore, pagesat e grumbulluara sipas këtij neni do të kalkuloohen

në pajtim me shpenzimet administrative specifike të cilat janë bërë gjatë procedimit të akteve të cilave u referohen pagesat në fjalë.

5. Procedurat dhe afatet për pagesa do të përcaktohen në rregullat që do të përgatiten dhe publikohen nga KPMM. KPMM do të sigurojë se të gjitha pagesat e tilla të pranuar nga KPMM janë depozituar në llogarinë e të ardhurave të dedikuara të KPMM-së, e cila është themeluar në pajtim me Rregullat e kontrollit dhe menaxhimit financiar dhe me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Neni 42

1. Neni 68 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Me Inspektoratin e Minierave udhëheqë Kryeinspektori i cili zgjedhet nga Bordi i KPMM-së në përputhje me Ligjin në fuqi për shërbimin civil. Bordi i KPMM-së duhet të sigurojnë që personi në fjalë:

2. Neni 68 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Bordi i KPMM-së mund ta shkarkojë Kryeinspektorin nëse ka arsye të mira dhe bindëse për shkarkim. Këto arsye përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në këto:

3. Neni 68 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Vendimi i Bordit për shkarkimin e Kryeinspektorit behet me shkrim dhe të përmbajë arsyetimin për marrjen e vendimit. Kryeinspektori i shkarkuar ka të drejtë të kundërshtojë këtë vendim në përputhje me Ligjin për shërbimin civil.

4. Neni 68 i ligjit bazik, paragrafi 5. fshihet fjala “**Ministri**”.

5. Neni 68 i ligjit bazik, paragrafi 6. fshihet fjala “**Kuvendit**”.

Neni 43

Neni 70 i ligjit bazik, në paragrafin 3. fjala “**konfiskim**” zëvendësohet me fjalën “**sekuestrim**”.

Neni 44

1. Neni 73 i ligjit bazik, paragrafi 4. riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Asnjë Autoritet Publik nuk mund të miratojë ose zbatojë ndonjë plan hapësinor ose urbanistik pa pëlqimin e Ministrisë. Para dhënies së këtij pëlqimi, Ministria duhet të këshillohet me KPMM. Ministria duhet ta japë pëlqimin në fjalë përveç nëse KPMM i dorëzon Ministrisë një shpjegim me shkrim i cili në mënyrë të qartë tregon se zbatimi i një plani të tillë do të ndërhyjë në masë të konsiderueshme me hulumtimin e koordinuar dhe të qëndrueshëm të Resurseve Minerale në Kosovë.

2. Neni 73 i ligjit bazik, pas paragrafit 4. shtohen paragrafet e rinjë 5.,6.,7., dhe 8. me tekstin si në vijim:

5. Bazuar në Strategjinë Minerare, Ministria në bashkëpunim me Insitutin Gjeologjik të Kosovës dhe KPMM përgatit dhe Qeveria e Republikës së Kosovës miraton Programin për Zbatimin e Strategjisë Minerare për një periudhë se paku tre (3) vjeçare. Ministria është përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin të këtij programi.

6. Programi për zbatimin e Strategjisë Minerare përcakton masat dhe aktivitetet që duhen zbatuar përfshirë, parashikimin e shpenzimeve dhe burimet e pritura të financimit, kohën e pritshme të realizimit si dhe përcakton subjektet përgjegjëse për implementim.

6.1. Për Zbatimin politikave të Strategjisë Minerare, Qeveria mund të miratojë legjislacion sekondar, në rast se kjo është e domosdoshme.

7. Te gjitha institucionet relevante në sektorin minerar janë të obliguar të përmbahen obligimeve që rrjedhin nga Strategjia Minerare dhe Programi për Zbatimin e Strategjisë Minerare.

8. Në fund të çdo viti kalendarik, Ministria harton dhe paraqet raportin vjetor të progresit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, mbi progresin e realizimit të Programit për Zbatimin e Strategjisë Minerare. Ky raport duhet të paraqitet brenda tremujorit të parë të vitit vijues kalendarik.

Neni 45

Neni 74 i ligjit bazik riformulohet si vijon:

Neni 74 **Menaxhimi i resurseve minerale**

1. Gjatë tre mujorit të fundit të secilit vit kalendarik, KPMM përgatit dhe dorëzon në Ministri Projekt-Planin për Menaxhimin e Resurseve Minerale për vitin vijues. Ky plan duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Minerare të Kosovës.

2. Ministria në afatin prej tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit, shqyrton, ndryshon nëse e sheh të arsyeshme. miraton dhe shpall Planin për Menaxhimin e Resurseve Minerale. KPMM zbaton planin e tillë dhe në rast nevojë, bën rekomandime Ministrisë përkitazi me modifikimin apo zbatimin e tij.

Neni 46

1. Titulli i Kreu III i ligjit bazik ndryshohet me tekstin si në vijim: **“Agjencia Gjeologjike e Kosovës (AGJK)”**.

2. Neni 77 i ligjit bazik, paragrafi 2. nënparagrafi 2.1. ndryshohet shkalla **“një me pesëdhjetëmijë (1:50,000);”** në **“një me njetetë e pesëmijë (1:25,000);”**.

Neni 47

1. Neni 78 i ligjit bazik, titullit i shtohet emri **„TREPÇA“**.

2. Neni 78 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Muzeu Shtetëror i Kristaleve dhe Mineraleve - **“TREPÇA“**(“Muzeu”) themelohet me këtë ligj në kuadër AGJK-së.

3. Neni 78 i ligjit bazik, në paragrafët 2. dhe 5., fjala **“Ministria apo Ministri“** zëvendësohet me **“AGJK“**.

4. Neni 78 i ligjit bazik, paragrafët 3. dhe 4. fshihen nga teksti i ligjit.

5. Neni 78 i ligjit bazik, paragrafi 5. riformulohet me tekstin si në vijim :

5. Ministria nxjerrë akt nënligjor për llojet specifike të strukturave kristalore dhe strukturave me përmbajtje kristalore të cilat bartësit e licencave për hulumtim dhe shfrytëzim janë detyruar të mbledhin ruajnë dhe dorëzojnë në muze.

Neni 48

Pas nenit 78 të ligjit bazik shtohet neni i ri 78.A me tekstin si në vijim:

Neni 78.A

Detyrimi i udhëheqjes, pjesët përbërëse të regjistrit dhe evidentimi

1. Me qëllim të menaxhimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjen e resurseve minerale, KPMM dhe Ministria përgjegjëse për sektorin mineral, udhëheqin sistem informacioni unik për resurset minerale, i cili është pjesë përbërëse e regjistrit të fushave të lejuara hulumtuese dhe regjistrit të fushave të shfrytëzimit të resurseve minerale.
2. KPMM, është i obliguar se veç regjistrit nga paragrafi 1. i këtij neni, të mbajë edhe evidencën e të gjitha kërkesave për hulumtim dhe shfrytëzim, të dhënat për bartësit e licencave/lejeve.
3. KPMM, është e obliguar se të dhënat nga sistemi informativ unik për resurse minerale të tubuara sipas paragrafëve 1. dhe 2. të këtij neni, pas pranimit të tyre të përcjellë në Ministrinë përgjegjëse për sektorin mineral.
4. Sistemi informativ unik për resurset minerale, regjistri i fushave të lejuara të hulumtimit, regjistri i fushave të miratuara të shfrytëzimit të resurseve minerale, mënyra e mbajtjes së evidencës për kërkesat e fushave të hulumtimit dhe të shfrytëzimit, mënyra e udhëheqjes dhe mbajtjes së dokumentacionit të bartësit të licencës/lejes, do të përcaktohen me rregullore të nxjerrë nga Ministri përgjegjës për sektorin mineral në bashkëpunim me KPMM.

Neni 49

Neni 80 i ligjit bazik, paragrafi 1. pas fjalës “mineraleve“ shtohet togfjalëshi “ dhe lejët për aktivitetet e veçanta“.

Neni 50
Hyrja në Fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 04/ L-158
28 mars 2013

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Jakup KRASNIQI